

AGJENDA E KONTRATËS SOCIALE – PËR KOMUNËN E PRIZRENIT

HYRJE

Komuna e Prizrenit dhe qytetarët e saj zotohen të zbatojnë Agjendën e Kontratës Sociale të dakorduar nga përfaqësuesit e të dyja palëve për të përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin midis qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës.

Objektivat e Agjendës janë:

- të mbështetë bashkëpunimin e hapur, të sinqertë dhe domethënës midis zyrtarëve komunal dhe qytetarëve për të zgjidhur çështjet e banorëve;
- të ndihmojë qytetarët dhe zyrtarët komunal që të kuptojnë më mirë përgjegjësitë dhe kontributin e njëri-tjetrit;
- të inkurajojë respektin për diversitetin e përvojave dhe opinioneve ndërmjet qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës dhe
- të ndërtojë besimin midis qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës..

ZOTIMI PËR PËRMIRËSIMIN E PRAKTIKAVE TË PJESËMARRJES

Korniza ligjore e Kosovës ofron disa mekanizma për pjesëmarrjen publike. Nga një gamë e gjerë e mekanizmave dhe praktikave në dispozicion, grupet e qytetarëve dhe zyrtarët komunal pajtohen të fokusohen në mënyrat në vijim për të përmirësuar pjesëmarrjen publike:

Përdorimi më i madh i kanaleve digjitale të komunikimit

- Komuna e Prizrenit zotohet të përdorë më mirë platformat e medieve sociale, siç është Facebook dhe Instagram, për të komunikuar me qytetarët dhe për t'u angazhuar me ta lidhur me çështjet e identifikuar. Zyrtarët e komunës po ashtu do të përmirësojnë përdorimin e mjeteve konvencionale të informimit për të moshuarit dhe grupet e tjera të qytetarëve që nuk e përdorin rregullisht internetin. Zyrtarët komunal dhe grupet e qytetarëve zotohen të mobilizojnë publikun në një shkallë më të gjerë për të përdorur kanalet ekzistuese të komunikimit brenda Komunës. Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) do t'i ofrojnë Komunës rrëfime suksesi të ndërveprimeve konstruktive midis zyrtarëve të komunës dhe qytetarëve ashtu që ato të mund të shërbejnë si model për të ardhmen. Në mënyrë specifike, Komuna do të riaktivizojë llogarinë e saj zyrtare të Instagram dhe do të caktojë zyrtar/etë dedikuar për ta menaxhuar atë.
- Komuna zotohet të përdorë mjetet e komunikimit online për të krijuar grupe dhe për të mobilizuar qytetarët (p.sh. grupet në Viber të anëtarëve me interesa të përbashkëta, faqet në Facebook të fshatrave ose lagjeve, listat e emaileve të të rinjëve ose grupeve të tjera joformale të qytetarëve etj.). Të gjithë zyrtarët komunal dhe grupet e qytetarëve mund të përdorin këto grupe të medieve sociale për të ndarë informacione në kohë reale në mes Komunës dhe grupeve specifike të qytetarëve (p.sh. rinisë, grave etj.).
- Të gjitha Drejtoritë zotohen të trajtojnë të gjitha kërkesat e dërguara me email si kërkesa zyrtare dhe të përgjigjen me kohë të caktuar. Komuna zotohet të përmirësojë sistemin e saj për gjurmimin dhe përgjigjen ndaj kërkesave të qytetarëve dhe caktimin e një ekipi të dedikuar për t'u përgjigjur kërkesave të qytetarëve.
- Komuna e Prizrenit, në bashkëpunim me OShC-të, zotohet të zhvillojë një bazë të dhënash të palëve të interesit që do të përfshijë informacionet e kontaktit të përfaqësuesve të komunitetit pas marrjes së pëlqimit të tyre, ashtu që Komuna të mund të komunikojë me lehtësi me publikun e gjerë dhe grupet specifike të qytetarëve (p.sh. rininë, gratë, personat me aftësi të kufizuara, të pensionuarit, sportistët, artistët etj.).

Konsultimet publike gjithëpërfshirëse

- Komuna zotohet të organizojë diskutime në grupe të vogla të paktën një herë në muaj për tema specifike për grupe të interesit që rrallë marrin pjesë në diskutime publike, siç janë rinia, personat me nevoja të veçanta, të moshuarit, gratë dhe përfaqësuesit nga komunitetet joshumicë. Për të mbuluar këto grupe të qytetarëve, Komuna zotohet të bashkëpunojë me qytetarët dhe organizatat e rrjetëzuara (p.sh. me liderët e komunitetit, kryetarët e shoqatave të lagjeve, këshillat e fshatrave dhe OShC-të lokale). Grupet e qytetarëve, duke përfshirë organizatat joqeveritare (OJQ-të),

zotohen të shpërndajnë informacionet për konsultime publike dhe ngjarjet e tjera të ndërlidhura brenda rrjetit të tyre dhe të avokojnë për pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve.

- Komuna zotohet të informojë qytetarët për procesin e dëgjimit buxhetor dhe diskutime të tjera për caktimin e prioriteteve për të rritur pjesëmarrjen dhe transparencën në alokimin e buxhetit. Komuna zotohet të thjeshtësojë prezantimin e draft buxhetit dhe t'ia prezantojë atë në lagje dhe fshatra të ndryshme për të inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në dëgjimet buxhetore. Komuna zotohet të mbledhë kërkesat e qytetarëve dhe t'i informojë ata në mënyrë transparente nëse një kërkesë e caktuar e qytetarëve po shqyrtohet në zhvillimin e buxhetit komunal. Grupet e qytetarëve, OJQ-të dhe këshillat lokalë zotohen të shpërndajnë edhe më tej draft buxhetet për secilën zonë brenda rrjeteve të tyre për të siguruar informim më të gjerë të qytetarëve.
- Për të rritur besimin në zbatimin e projekteve të përcaktuara bashkërisht, Komuna zotohet të inkurajojë qytetarët që të marrin pjesë si vëzhgues në komitete të ndryshme, p.sh. për prokurim. Komuna zotohet t'u lejojë qytetarëve të monitorojnë zbatimin e projekteve të ndryshme. OJQ-të zotohen të jenë më aktive në monitorimin e zbatimit të projekteve dhe të ofrojnë rekomandime, pa ndërhyrë në proceset e prokurimit.

Fuqizimi i Këshillave Lokalë

- Zyrtarët komunal zotohen të konsultohen me përfaqësuesit e Këshillave Lokalë (kur ata janë të themeluar), grupet e interesit, si dhe me grupet e lagjeve para dëgjimeve publike për të marrë komentet e tyre dhe për të avokuar për pjesëmarrje më të lartë të qytetarëve.
- Një grup i përbashkët i zyrtarëve, qytetarëve dhe anëtarëve të Këshillave Lokalë zotohen të takohen çdo tre muaj për të mbledhur kërkesat për nevojat e qytetarëve. Këshillat Lokalë zotohen të mbledhin informacione (kërkesa, nevoja dhe rekomandime) dhe të ndajnë skedarin me Drejtorinë e Administratës, duke i klasifikuar kërkesat, nevojat dhe rekomandimet sipas prioritetit. Drejtoria e Administratës zotohet të adresojë kërkesat te Drejtoritë përkatëse dhe të informojë Këshillin Lokal për statusin e të gjitha kërkesave.
- Qytetarët zotohen të marrin pjesë në trajnime për mënyrën e mbledhjes së informacioneve nga Komuna dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në planifikimin buxhetor të organizuar nga Aktiviteti Kontrata Sociale.
- Komuna zotohet të nisë modele atraktive për të angazhuar qytetarët përmes shpërblimeve komunitare jofinanciare siç është “Shpërblimi për lagjen më të pastër.” Grupet e qytetarëve dhe OJQ-të zotohen të organizojnë iniciativa vullnetare për të mbështetur këto nisma.

Rritja e informimit publik dhe promovimi i komunikimit gjithëpërfshirës

- Komuna zotohet të zhvillojë strategji të detajuar komunikimi e cila përfshin konferenca për media javore nga Kryetari i komunës, ku shpjegohen politikat dhe planet e propozuara që janë në proces në lagje të ndryshme. Komuna zotohet po ashtu të përdorë më shumë mediet tradicionale dhe online për të informuar qytetarët për zhvillimet në Komunë.
- Komuna zotohet të krijojë një seksion informativ me Pyetjet Më të Shpeshta dhe të shtojë një lidhje për informacionet e dhëna me uebsajtin e komunës.
- Për të arritur qytetarët që janë më pak të orientuar në aspektin digjital, Komuna zotohet të eksplorojë modalitete të tjera për ndarjen e informacioneve publike, siç është SMS. OJQ-të lokale zotohen të shpërndajnë informacione të tilla te qytetarët në fshatrat dhe zonat e largëta.
- Komuna zotohet të hartojë dhe të publikojë kalendarin vjetor të ngjarjeve në uebsajtin komunal dhe llogaritë e medieve sociale dhe tabelën e njoftimeve, bazuar në marrëveshjen reciproke të arritur me qytetarët.
- Komuna zotohet të vë në dispozicion të gjitha informacionet zyrtare në të gjitha gjuhët zyrtare sipas kërkesave ligjore. Plani për transparencë (të cilin komuna e ka përmendur se është i gatshëm për diskutim publik) do të përfshijë një përmbledhje ekzekutive dhe prezantim PowerPoint për të theksuar veçoritë kryesore të planit duke përdorur gjuhë të thjeshtëzuar. Për planifikimet e ardhshme komunale, Komuna zotohet të konsultohet me qytetarët me dokumente në gjuhë të thjeshtë dhe stile prezantimi angazhuese, si slajde në PowerPoint, tryeza të rrumbullakëta, pyetësorë, anketa online etj. Qytetarët zotohen të marrin pjesë në mënyrë aktive në takime publike dhe të ndajnë ftesat për këto takime brenda rrjeteve të tyre të paktën një javë paraprakisht.
- Komuna zotohet të promovojë qytetarët që kontribuojnë dhe përfshihen në procesin e vendimmarrjes lokale duke krijuar një sistem formal të njohjes publike të aktivizimit të tyre. Komuna

zotohet për një proces të përzgjedhjes që është transparent dhe që realizohet përmes votimit. Qytetarët zotohen të propozojnë kandidatët që potencialisht do të përzgjidhen si qytetarë aktivë, të promovojnë nominimet dhe të marrin pjesë në procesin e votimit.

- Grupet e qytetarëve dhe OJQ-të zotohen të shpërndajnë materiale komunikimi brenda rrjeteve të tyre për të promovuar angazhim më të gjerë të qytetarëve. Komuna do të përdorë teknika të informimit që përdoren nga sektori privat për të përfshirë të njëjtin nivel të entuziazmit në informim siç bëjnë bizneset kur kontaktojnë me klientët e tyre.

ÇËSHTJET E BANORËVE QË DUHET TË ADRESOHEN BASHKËRISHT NGA QYTETARËT DHE ZYRTARËT KOMUNAL NË PRIZREN

Përfaqësuesit e komunitetit dhe zyrtarët publikë të Prizrenit kanë identifikuar dhe kategorizuar bashkërisht listën vijuese të çështjeve të banorëve.

I. OBJEKTE SANITARE – TUALETE PUBLIKE TË QASSHME

Përshkrimi i problemit

Komuna e Prizrenit është një qendër historike dhe kulturore e Kosovës që tërheq mijëra vizitorë përgjatë vitit. Megjithatë, Prizrenit i mungojnë objekte sanitare- tualete publike të qasshme për persona me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye, është thelbësore që Komuna e Prizrenit të ndërtojë objekte sanitare publike që do të jenë të qasshme për të gjithë banorët dhe vizitorët e tij. Njësitë sanitare publike në zonat e frekuentuara në qendër të qytetit të Prizrenit do të ofrojnë një mjedis më të pastër/sigurt për të gjithë, qasje më të madhe për komunitetin dhe vizitorët dhe qasje për personat me aftësi të kufizuara. Qytetarët dhe zyrtarët komunal propozuan katër lokacione ku do të mund të instaloheshin tualetet publike, përkatësisht Ura e Arastës, Parku i qytetit dhe dy lokacione të tjera të mundshme.

Objektivi

Objektivi i këtij intervenimi është angazhimi i pjesëtarëve të komunitetit, personave me aftësi të kufizuara dhe institucioneve komunale që të instalojnë njësi sanitare të qasshme për persona me aftësi të kufizuara në zonat në qendër të qytetit të Prizrenit.

Plani i veprimit për zgjidhjen e çështjes

Përcaktimi i rrjedhës së veprimit

1. Komuna zotohet të rishikojë dhe të zhvillojë një plan veprimi bazuar në rekomandimet e publikimit “Tualetet publike në qytetin e Prizrenit”, të publikuar në muajin gusht 2022 nga “Ec ma ndryshe.” Përfaqësuesi i OShC-së ia dorëzon informacionet Drejtorisë së Shërbimeve Publike të komunës.
2. Komuna kërkon opinionet e ekspertëve për të përcaktuar koston e mirëmbajtjes. Në bashkëpunim me qytetarët, Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe OJQ-të përcaktojnë vendndodhjet sipas studimit të fundit.
3. Drejtoria e Shërbimeve Publike ndan prezantimin me publikun dhe fton qytetarët në diskutim publik. Gjatë diskutimeve, qytetarët ofrojnë reagimet e tyre për koston ideale për përdoruesit, masat e sigurisë dhe vendndodhjet e tualeteve publike;
4. Arkitektët e komunës dhe përfaqësuesit e komunitetit do të zhvillojnë bashkërisht specifikimet teknike për këtë intervenim. Komuna do të ftojë qytetarët që të marrin pjesë në hartimin e specifikimeve teknike dhe dizajnin përfundimtar.
5. Përfaqësuesit e komunitetit informojnë personat brenda rrjeteve të tyre që të marrin pjesë në procesin e monitorimit.
6. Komuna publikon njoftimin e prokurimit publik dhe ia dërgon ftesat publikut. Zyra e Prokurimit publikon dokumentet dhe procedurat e prokurimit sipas kërkesave ligjore.
7. Komuna dhe qytetarët diskutojnë dhe pajtohen të monitorojnë bashkërisht procesin e ndërtimit dhe të mbikëqyrin mirëmbajtjen e tyre. Komuna ndan ftesat me grupet e qytetarëve dhe OJQ-të që ata të marrin pjesë në procesin e përbashkët të vendimmarrjes, i cili do të përfshijë pjesëmarrjen në procesin e vlerësimit të të gjitha ofertave të marra nga kompanitë përmes procesit të prokurimit publik. Zyra e Informimit do të ftojë qytetarët të monitorojnë procesin e prokurimit, vlerësimin e tenderit dhe zbatimin e tij.
8. Qytetarët dhe zyrtarët komunal pajtohen për mënyrat më të mira për t’i raportuar Komunës për çështjet që lidhen me tualetet. Komuna e Prizrenit siguron mirëmbajtje të rregullt të njëjësive

sanitare për të garantuar qëndrueshmërinë e këtij intervenimi. Komuna rishikon mënyra të përshtatshme për të siguruar mirëmbajtjen e tyre, ndërsa qytetarët raportojnë (duke përdorur sistemin e dakorduar) kur njësitë sanitare janë jashtë funksionit.

Palët e interesit

Këshillat rinorë, OJQ-të lokale duke përfshirë Dokufest, organizatat që përfaqësojnë grupet minoritare, personat me aftësi të kufizuara, shoqatat e arkitektëve, qytetarët dhe vizitorët e Prizrenit.

Praktikat që do të aplikohen për zgjidhjen e çështjes

- **Rritja e informimit publik dhe promovimi i komunikimit përfshirës.** Komuna do të publikojë propozimet e marra dhe inkurajojë qytetarët për të marrë pjesë në diskutimet publike. Rekomandimet nga “Ec ma ndryshe” do të përdoren si bazë për intervenimin. Ekspertët e përzgjedhur teknikë do të ofrojnë detaje teknike, duke përfshirë koston e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së njësiteve sanitare.
- **Konsultimet publike gjithëpërfshirëse.** Komuna do të ftojë qytetarët të marrin pjesë në diskutime publike për këtë nismë. Drejtoria e Shërbimeve Publike do të planifikojë dhe organizojë një dëgjim publik për të marrë reagimet nga publiku i gjerë për vendndodhjen, mirëmbajtjen dhe qasjen për persona me aftësi të kufizuara. Komuna do të fton qytetarët përmes medieve sociale, platformave online dhe mënyrave tradicionale për të inkurajuar pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në procesin e konsultimit.

2. FUNKSIONALIZIMI I QENDRËS RINORE

Përshkrimi i problemit

Aktivistët e rinj dhe pjesëtarët e komunitetit janë dakorduar me zyrtarët e komunës së Prizrenit që të funksionalizojnë Qendrën Rinore dhe ta vënë në dispozicion këtë hapësirë për aktivitete të rinjve, duke siguruar qasje për personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë dhe pjesëtarët e komunitetit. Qëllimi i Qendrës është zgjerimi i njohurive të rinjve për letërsi, art dhe TI, si dhe mundësi të mësimi për gra dhe vajza me formime të ndryshme.

Objektivat

Objektivat e përgjithshme të këtij intervenimi janë 1) që të rinjtë të adresojnë nevojat e tyre për një Qendër më moderne dhe gjithëpërfshirëse dhe 2) krijimi i një kanali të komunikimit me Komunën për të ofruar mundësi mësimi për të gjithë të rinjtë e Prizrenit.

Plani i veprimit për zgjidhjen e çështjes

Përcaktimi i rrjedhës së veprimit

1. Të rinjtë e interesuar të Prizrenit nisin seri diskutimesh që lidhen me funksionalizimin e Qendrës. Një përfaqësues i komunitetit/arkitekt do të angazhohet në procesin e diskutimit nga fillimi për të përcaktuar se çfarë mund dhe duhet të rinovohet, për të diskutuar për mundësinë e rinovimit dhe për të sugjeruar ide dhe koncepte për funksionalizimin e saj. Të gjitha vendimet lidhur me qendrën rinore/kulturore duhet të merren bashkërisht dhe në mënyrë transparente. Gjatë muajit dhjetor 2022 dhe në vitin 2023, Komuna do të ftojë qytetarët në diskutime publike për funksionalizimin e Qendrës Rinore. Aktivistët e rinj zotohen të ftojnë qytetarët dhe të gjitha palët e interesuara brenda rrjeteve të tyre që të marrin pjesë në këto diskutime.
2. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të Komunës, do të kërkojnë opinionet e ekspertëve për të përcaktuar koston e funksionalizimit të qendrës. Komuna do të kryejë një vlerësim të detajuar në lidhje me këto intervenime dhe do ta ndajë atë me publikun. Komuna zotohet të ftojë dhe të përfshijë një arkitekt të zërgjedhur nga komunitetit që të prezantojë praktikën më të mira për rinovimin e Qendrës Rinore.
3. Gjatë konsultimeve publike, zyrtarët komunal dhe qytetarët do të diskutojnë dhe do të pajtohen për rinovimin e Qendrës Rinore, ndërsa sigurojnë qasjen për personat me aftësi të kufizuara. Drejtoria e Planifikimit Urban do të kërkojë ekspertizë për koston e platformës së pjerrët për qasje dhe do të diskutojë gjetjet me qytetarët.
4. Arkitektët e komunës dhe përfaqësuesit e komunitetit do të hartojnë bashkërisht specifikat teknike për të gjitha intervenimet.

5. Komuna dhe qytetarët zotohen të caktojnë nga tre përfaqësues secila palë për të monitoruar bashkërisht procesin e funksionalizimit, të cilët do të monitorojnë dhe publikojnë rezultatet e procesit..
6. Komuna dhe përfaqësuesit e komunitetit do të organizojnë një ceremoni të quajtur “Dita e hapur” si festim që mirëpret të gjithë qytetarët për të inauguruar bashkërisht qendrën pasi të përfundohet funksionalizimi i saj.
7. Komuna e Prizrenit do të sigurojë mirëmbajtjen e rregullt të saj për të garantuar qëndrueshmërinë e këtij intervenimi. Plani i menaxhimit të Qendrës do të specifikohet sipas legjislacionit sekondar që rregullon shfrytëzimin e qendrave sportive dhe kulturore.
8. Përfituesit e Qendrës do të zhvillojnë bashkërisht kalendarin dhe orarin e shfrytëzimit dhe do t’ua publikojnë r që të gjithë qytetarët të kenë qasje.

Palët e interesit

OJQ-të lokale, përfaqësuesit e organizatave për personat me aftësi të kufizuara, personat me aftësi të kufizuara dhe ata që kujdesen për ta, grupet, grupet e qytetarëve, banorët e lagjeve, grupet kulturore dhe të rinjtë..

Praktikat që do të aplikohen për zgjidhjen e çështjes

- **Përdorimi më i madh i kanaleve digjitale të komunikimit.** Aktivistët e rinj do të nisin një fushatë në medie sociale për ofruar informacione për nismën për funksionalizimin e Qendrës Rinore, për të stimuluar të rinjtë e tjerë që të marrin pjesë në këtë proces. Shoqata lokale e arkitektëve dhe aktivistët e rinj do të ofrojnë ide për funksionalizimin e Qendrës nga qytetarët. Për më shumë, Komuna do të shpërndajë informacionet për funksionalizimin përmes medieve sociale dhe platformave online për të theksuar shërbimet që Qendra do të ofrojë.
- **Dëgjimet publike gjithëpërfshirëse.** Aktivistët e rinj dhe përfaqësuesit e grupeve të tjera të qytetarëve do të përgatitin dhe do të lehtësojnë një konsultim për marrjen e inputit nga të rinjtë.. Ata do të përgatisin një plan informimi për konsultimet dhe, përmes këtij procesi, do të zhvillojnë një projekt bazuar në reagimin e marrë nga konsultimet. Aktivistët e rinj do t’ia dorëzojnë propozimin Komunës për shqyrtim.

Të shtohet pas marrëveshjes së Agjendës së Kontratës Sociale për Komunën e Prizrenit:

Kjo Agjendë e Kontratës Sociale u dakordua nga zyrtarët e Komunës së Prizrenit dhe 22 përfaqësues të komunitetit në një proces të lehtësuar dhe të mbështetur nga Aktiviteti i USAID-it “Kontrata Sociale” gjatë periudhës gusht - nëntor 2022. Zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e komunitetit zotohen të zbatojnë veprimet e sipërpërmendura brenda një periudhe prej 18 muajsh. Zyrtarët komunal dhe grupet e qytetarëve zotohen të takohen në baza tremujore për të monitoruar progresin e kësaj Agjende të Kontratës Sociale.